



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Inspeksionit
Periudha Raportuese	Dhjetor, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Adelina Ademi

1. PËRMBLEDHJE

Gjatë muajit dhjetor, mbarëvajtja e punëve ishte në nivelin e duhur, më përjashtime të emergjencave eventuale të paparashikuara, si dhe dinamikës së punës.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarja e punëve dhe detyrave të punës, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorëve, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve ditore, javore dhe mujore të punës;
- Monitorimi i deponive ilegale në territorin e Prishtinës;
- Vizita nëpër objekte për të cilat kemi pasur njohuri se nuk i zbatojnë rregullat, si dhe vërejtjet paraprake ambientale;
- Inspektim të transportit publik;
- Inspektim të lokaleve afariste sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;

- Inspektim të lokaleve afariste në lidhje me çështjen për konsumim të duhanit brenda ambienteve ku është e ndaluar pirja e duhanit etj.;
- Mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulante;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Ndërtim:

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektimi final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Fletëthirrje – 62;
- Procesverbale – 64;
- Aktvendime për ndërprerje të punëve – 19;
- Aktvendime për rrënim – 3;
- Ekzekutim i aktvendimit për rrënim – 1;
- Ekzekutim i aktvendimit për rrënim nga vet pala –1;
- Gjoha mandatorë – 17;
- Gjithsej shuma e përgjithshme – 6900.00 €;
- Gjoha të paguara – 10, në shumën prej 3700.00€;
- Gjoha të papaguara –7, në shumën prej 3.200.00 €;
- Dërgim i lëndës me AP, në Avokaturën komunale për gjoha mandatorë – 12;
- Kërkesë drejtuar Zyrës ligjore, për krijim të konfliktit administrativ ndaj vendimit të MMPH-së – 0.

Pylltaria:

- Konfiskimi i druve – 10.26 m³;
- Kërkesa të rregullta për prerjen e pyjeve private – 5;
 - Kërkesa të shqyrtuara nga APK-ja, – 0;
 - Numri i lejeve të dhëna – 0;
- Fletëparaqitje për kundërvajtje – 2;

- Fletëparaqitje penale – 1.

Rendi komunal:

- Lëndë të pranuar – 133;
- Procesverbale – 31;
- Lëndë të iniciuara për gjykatë – 3;
- Ankesa – 9;
- Kërkesa – 10;
- Kërkesë për lirim të punës – 0;
- Kërkesë për asgjësim të mallit – 4;
- Kërkesë për zhvarrosje – 0;
- Dëmtim i gypit të ujës-jellës – 2;
- Gropim dhe dëmtim i rrugëve dhe hapësirës publike – 3;
- Hedhje e dheut dhe mbeturinave – 3;
- Inspektim-mbikëqyrje, higjiene-sanitare, pajisja me pëlqim sanitar – 1;
- Mosrespektim i vendimit të Qeverisë për masat anti COVID-19, – 3;
- Inspektim-kontrolle për zbatim të vendimit të Qeverisë dhe Komunës (masat për parandalim të pandemisë), kontrolle në vazhdimësi;
- Pëlqime sanitare – 20;
- Inspektim i produkteve ushqimore (furra e bukës), afatet e përdorimit – 0;
- Konstatime – 3;
- Mosrespektim i rendit të udhëtimit – 0;
- Ndotje e rrugës – 1;
- Dëmtim i hapësirës publike të gjelbëruara – 0;
- Rrjedhje uji – 3;
- Shfrytëzim i hapësirës publike pa leje përkatëse – 8;
- Ekspozim i mallit, shitës ambulantë në të gjithë tregjet – 0;
- Taksi pa leje pune – 0;
- Gjoha mandatorë – 14 (gjithsej);
- Aktpërcjellës për përmbarim të gjobës – 1;
- Plane operative në transport publik dhe shitësve ambulantë në vazhdimësi;
- Ftesa në GJKK – 0.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Spektori i pylltarisë:

- Hartimi i raporteve për muajin dhjetor, 2020 dhe dërgimin e tij Agjencisë Pyjore të Kosovës;

- Llogaritja e fletëparaqitjeve dhe inicimi i procedurave gjyqësore dhe procedimi i tyre nëpër gjykata kompetente, si dhe kontaktimi më gjyqtarë për harmonizimin e dispozitave ligjore;
- Kontrollimi i terreneve pyjorë dhe transportimi i masës drunore;
- Mbështetja dhe shpjegimi i procedurave për aplikim të marrjes së lejes për shfrytëzimin e pyjeve private;
- Pranimi i palëve dhe aktivitete të tjera;
- Kontaktim dhe bashkëpunim me drejtorinë koordinuese të APK-së (Planet e menaxhimit të pyjeve për vitin 2019) etj.

Spektori i Rendit komunal:

- Kontrolle dhe inspektime në terren në vazhdimësi nga ana e inspektorëve;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik dhe për shitës ambulante;
- Inspektim të hapësirave publike;
- Inspektim dhe mbikëqyrje të bizneseve të ndryshme për plotësim të kushteve teknike higjiene – sanitare;
- Inspektim dhe mbikëqyrje të maketeve për produkte ushqimore pa afat.

Spektori i ndërtimit

- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërrerja e ndërtimeve pa leje, të evidentuara;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Rrënimi i objekteve pa leje;
- Inspektimi final i objekteve ndërtimore.

5. STATISTIKAT

5.1. Takimet me palë

Të dhënat e mëposhtme janë relative:

Spektori i ndërtimit –120;
 Spektori i pylltarisë – 45;
 Spektori i rendit komunal – 180;
 Kabineti i drejtorit – 22.

5.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Rendi komunal

- Lëndë të kryera –11;
- Lëndë në procedurë – 65;

- Njoftime nga drejtoritë tjera – 32;
- Vendime (refuzim kërkesë për reklama) – 5;
- Kërkesa nga GJTHDK-ja, për plotësim adrese – 0;
- Pezullime nga gjykatat – 3;
- Hedhje poshtë nga gjykatat – 1;
- Dënime nga gjykatat – 1;
- Hedhje poshtë e aktakuzës –1;
- Fletëthirrje nga Gjykata Themelore në Prishtinë – 3;
- Kërkesë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për plotësim të të dhënave – 0;
- Aktvendim pezullues për mungesë provash – 0;
- Verifikim adrese – 0.

Sektori i ndërtimit

- Ankesa dhe kërkesa të qytetarëve – 123;
- Në procedurë – 6;
- Kërkesa për inspektim final – 7;
- Të shqyrtuara – 0;
- Ankesa dhe kërkesa të shqyrtuara – 206;
- Gjithsej ndërtime dhe (renovime) të evidentuara – 22;
- Lëndë në procedurë të lejes – 14;
- Me leje ndërtimore, pëlqime – 18;

Sektori i pylltarisë

- Të hyrat nga pyjet private – 00 €;
- Të hyrat nga pyjet publike – 00 €;
- Gjithsej – 00 €.

6. SFIDAT

- Mungesa e planeve rregulluese detyron qytetaret të tentojnë për ndërtime pa leje;
- Duke u mbështetur në raportimin e inspektorëve dhe diskutimet e shpeshta me ta për gjendjen në terren;
- Kemi konstatuar së shkeljet ligjore dhe ndërtimet informale, shumë shpesh ndodhin edhe për pasojë të vonesës tonë të (institucioneve), për t’iu prirë proceseve me planifikim;
- Ato, plane diku mungojnë e diku janë në shpërputhje me gjendjen faktike në terren dhe si të tillë vështirë të realizueshëm;
- Shumë shpesh qytetarët shprehen se kanë qenë dhe janë të gatshëm t’i nënshtrohen procedurave për t’u pajisur me leje përkatëse, por nga pamundësia për t’u pajisur me leje, në njërin anë, dhe nevojat e menjëhershme për banim (rritja e familjes, shtimi i kurorave, dhe kërkesa për banim më kualitativ etj.), i bën ata të zgjedhin zgjidhjen e menjëhershme të banimit, qoftë edhe duke e shkelur ligjin;

- Shumë shpesh qytetarët deklarojnë se edhe për pasojë të problemeve pronësore (jo gjithmonë për faj të tyre), nuk mund t'i nënshtrohen procedurave për t'u pajisur me leje përkatëse;
- Duke konsideruar veten tonë (institucionet) si shërbyes të qytetarëve, i propozojmë Zyrës ligjore të Komunës së Prishtinës, të shqyrtojnë mundësitë ligjore për hartimin e ndonjë rregulloreje, ose ndonjë akti tjetër administrativ, që qytetarëve me kërkesa të tilla dhe në situatat e përshkruara më lart, t'iu bëhet një zgjidhje më e shpejtë në ndërmjetkohën e sjelljes së planeve të reja, revidimit të atyre ekzistuese dhe rregullimit të problemeve pronësore;
- Përvoja dhe praktika të tilla duhet të ketë, por edhe nëse nuk gjenden, Drejtoria e Inspeksionit, Sektori i ndërtimit, shpreh gjithë gatishmërinë për bashkëpunim me Zyrën ligjore dhe me cilindo institucion tjetër;
- Kërcënimet e vazhdueshme, si dhe sulmet ndaj stafit janë sfida, për shkak se nuk ekziston mbështetje as shëndetësore, as financiare;
- Mungesa e stafit dhe numri shumë i vogël i inspektorëve, shkakton pamundësi të efikasitetit në punë për dy arsye, e para, pamundësia e mbajtjes nën kontroll në terren dhe identifikimi i lehtë i inspektorit dhe mbajtja nën presion të vazhdueshëm;
- Mungesa e automjeteve;
- Mungesa e aparateve fotografike;
- Lejet e lëshuara nga Drejtoria e Urbanizmit krijojnë konfuzitet, për shkak të mos përcaktimit të kuotave vertikale të fundmit të objekteve;
- Në mungesë të Inspektorit komunal të autorizuar vetëm për banim në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sipas Ligjin nr.04/L-134, për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, ne nuk kemi arritur të zbatojmë këtë ligj dhe aktet nënligjore;
- Mënyra e shqyrtimit dhe trajtimit të objekteve me shkallë të lartë të rrezikshmërisë (objekte të banueshme dhe të pabanueshme), pas identifikimit nga inspektorët e ndërtimit gjatë kontrollit ditor, si dhe pas pranimit të kërkesave të shumta nga qytetarët që kemi pranuar në Drejtorinë e Inspeksionit;
- Mungesa e lokacionit dhe tregut për shitjen e masës drunore;
- Mungesa e automjeteve për terren;
- Mungesa e lokacionit dhe hapësirës për vendosjen dhe sigurimin e druve të konfiskuara;
- Mungesë e rojeve të pyllit për ruajtja dhe mbrojtjen e terrenit;
- Pamundësia dhe nevoja për hapjen e 2, eventualisht 3 vendeve të reja pune për roje pylli;
- Prerësit ilegalë të pyjeve (recidivistë), të cilët janë të njohur për Policinë, Prokurorinë dhe nuk merren masa adekuate për t'i parandaluar ata.

7. REKOMANDIME

- Rritja e numrit të inspektorëve;
- Automjete për inspektim terreni;
- Aparatet fotografike;
- Sigurimi i kushteve për punë në zyrë nga aspekti teknologjik (kompjuterë, printerë etj.);
- Pagesa e rrezikshmërisë;
- Sigurimi në rast fataliteti në punë;
- Furnizim me mjete dhe instrumente matëse.

8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

- Obligimi i bizneseve për t'u pajisur me leje për shfrytëzimin e hapësirës publike;
- Largimi i deponive ilegale të mbeturinave;
- Largimi i mbeturinave inerte;
- Kontrollimi i sipërfaqeve të gjelbra publike;
- Mbikëqyrja e rrugëve rreth punishteve;
- Inspektim të transportit publik të udhëtarëve dhe mallrave;
- Inspektim i lokaleve afariste, kushteve sanitare, varrosjen e kafshëve;
- Inspektim të dëmtimit të rrugëve;
- Inspektim të hapësirave publike etj.;
- Organizimi dhe koordinimi i punëve brenda sektorit;
- Ndarje e punëve dhe detyrave të punës, si dhe kujdesi për angazhimin e plotë të punëtorëve brenda sektorit;
- Njoftimi me udhëzime dhe urdhëresa lidhur me punën në kuadër të sektorit;
- Mbikëqyrja për kryerjen e rregullt të punëve, në përputhje me ligjin dhe aktet tjera;
- Përcjellja e gjendjes në kuadër të sektorit, identifikimi i problemeve dhe vështirësive, si dhe propozimi i masave për mënjanimin e tyre;
- Përgatitja e planeve dhe raporteve javore, mujore dhe vjetore të punës;
- Inspektim të lokaleve afariste, sa i përket kushteve sanitare dhe tejkalimit të orarit të punës;
- Mbledhja e taksës komunale për shfrytëzim të hapësirës publike etj.;
- Aksione në vazhdimësi në transportin publik;
- Aksione në vazhdimësi për shitës ambulantë;
- Kontrollimi i terrenit;
- Ndërprerja e të gjitha ndërtimeve pa leje;
- Kontrollimi sistematik i objekteve me leje;
- Inspektim final i objekteve ndërtimore;
- Rrënimi i objekteve pa leje.